



---

**BASHKIA SKRAPAR**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës “Zylyftar Veleshnja”**

**LLOJI I PROCEDURËS: E HAPUR, E THJESHTUAR**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45320000-6**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1 644 859,93** (një milion e gjashtëqind e dyzetë e katërmijë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë e tre) lekë **pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Skrapar ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore për 3 vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se **40%** e vlerës së përlllogaritur të fondit limit të

---

objektit të prokurimit. *Për plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga dega e Tatim-Taksave ose vërtetim elektronik nga shërbimet e-Albania*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe pika 1 dhe pika 2, gërma b) dhe pika 3, të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1, të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023.

**Shënim :** *Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për detyrimet e maturuara për vitin 2023. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK*

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

**Argumentimi:** Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme**

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

---

- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.**

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve, si dhe:

1. Situacionin përfundimtar të objektit;
2. Akt kolaudimi objekti;
3. Çertifikaten e marrjes në dorezim të objektit

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, si dhe:

1. Situacionin përfundimtar të objektit;
2. Aktin e kolaudimit;
3. Faturat tatimore përfundimtare

***Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, pika 2.3.1 gërma a), plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht***

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

**2.3.2** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar një numër të paktën, prej **5 (pesë)** punonjësish në fushën e ndërtimit, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku punojësit e mësipërm të figurojnë sipas kodit përkatës të profesionit.

**Argumentimi:** Bazuar në ligjin. nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 79 dhe neni 77 pika 4, në të cilin thuhet: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.”, si dhe të VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 44 pika 1, AK kërkon cilësi dhe garanci të

mallrave duke qenë se këto mallra do të përdoren në objekte arsimore dhe koha e përdorimit të tyre duhet të jetë jo e shkurtër. Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminues për operatorët.

*Shënim: Çertifikatat e mësipërme/ekuivalente duhet të jenë të lëshuar nga Institucione të çertifikuara/akredituara në Shqipëri ose tek ato ndërkombëtare dhe në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë keto certifikata në perputhje me shërbimet/mallrat që ka marrë përsipër në marreveshjen e bashkëpunimit.*

### **3. TË PËRGJITHSHME**

Pavarësisht sa përcaktohet në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit”, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në pikën 2, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” dhe të paraqitura nga ofertuesi në formularin përmbledhës të deklaramentit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **Specifikimet Teknike**

Objekti i prokurimit: **“Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës “Zylyftar Veleshnja”**”, shoqërohet me projektin, grafikun e punimeve dhe me preventiv, të hartuar nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Skrapar, ka miratuar preventivin dhe është në fazën e prokurimit.

Për pasojë, kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik”, neni 36 “Specifikimet teknike”, si dhe VKM-së nr. 285 dt.12.5.2021 neni 2 “Dokumentimi i Procesit”, pika 2 gërma c), dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, lidhur me hartimin e specifikimeve teknike, konsiderohet e realizuar, pasi specifikimet janë hartuar dhe miratuar paraprakisht.

Specifikimet teknike do të jepen bashkëlidhur Dokumenteve Standarte të Tenderit, për procedurën tip “E Hapur, E Thjeshtuar”, Punë.

#### **Përfundime**

Me miratimin e kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit, kriterëve të vlerësimit, si dhe specifikimeve teknike, njësisia e Prokurimit miraton Dokumentet Standarte të Tenderit, për procedurën “E Hapur,

---

E Thjeshtuar”, “Punë”, me objekt prokurimi **“Hidroizolim solete i godinës së QKF dhe shkollës “Zylyftar Veleshnja””**.

Personi përgjegjës i prokurimit, pjesë e njësisë së prokurimit, të bëjë publikimin e procedurës në Sistemin e prokurimit elektronik, në faqen e APP-së.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**

**Altin Lamçe**

**Ernest Ymeri**

**Florand Osmani**

---